



Civil Society Organization
NEW HORIZON
 www.ngo-horizonti.org



Fond za aktivno građanstvo
 Fondi për qytetari vepruese

titulli i projektit:

**“POLITIKA H2K U2K/K
 V2ULJ IN**

.....**REZULTAT- u- =yOyU u@ @
 u2V- t\ K t- u2u2k@Kt-**

.....**UI , - 2014.**



Ovaj projekat finansira Evropska unija, posredstvom Delegacije EU u Crnoj Gori
 Këtë projekt e mbështetë Bashkimi Evropian, përmes Delegaionit të BE-së në Mal të Zi

SHËNIME HYRËSE

Ky dokument paraqet rezultatet e hulumtimit të problemeve dhe nevojave të të rinjve në komunën e Ulqinit, të realizuara në periudhën qershor – gusht 2014. Qëllimi themelor i hulumtimit ishte grumbullimi i informacionit për problemet aktuale dhe nevojat e të rinjve, në mënyre që hartimi i dokumentit **Plani i Veprimit për të rinj** në komunën e Ulqinit, të jetë sa më cilësor.

Për nevojat e këtij hulumtimi ne përdorëm mundësitë që ofron interneti për realizimin e anketimeve publike. Në një prej platformave të shumta që ofrojnë programe për anketim, vendosëm formularin e anketës, identik me atë që përdorëm në terren dhe përmes kanaleve të përshtatshme për komunikim, e lançuan këtë proces për grupin e synimit.

Mënyra tjetër në të cilën u zhvillua ky hulumtim, ishte ajo që “Horizonti i Ri” e zbaton tradicionalisht – anketimi në terren me anketues të trajnuar. Në këtë formë u realizua rreth 60% e procesit të anketimit të të rinjve.

Pyetësi ishte i hartuar nga dymbëdhjetë pyetje në të cilat janë përgjigjur 174 të rinj të moshës 15 – 29 vjeç. Hulumtimi ka përfshirë 9 fusha të interesit për të rinj: *edukimi, punësimi, shëndeti, pjesëmarrja e të rinjve në shoqëri, të drejtat e njeriut, koha e lire, kultura, familja, informimi dhe lëvizshmëria.*

Ky hulumtim paraqet një pjesë të projektit me titullin: **“POLITIKA PËR TË RINJ NË ULQIN”**, të cilën e realizon organizata e shoqërisë civile “Horizonti i Ri” nga Ulqini.

Aktivitetet e këtij projekti paraqesin vazhdimësinë e angazhimit shumëvjeçar të organizatës tonë, i cili ka për qëllim rritjen e përfshirjes së të rinjve në procesin e vendimmarrjes në nivelin lokal.

Qëllimet specifike të projektit janë:

- ✓ Inicimi i procesit të hartimit dhe miratimit të Planit të Veprimit për të rinj tek pushteti lokal,
- ✓ Informimi i përfaqësuesve të pushtetit lokal, institucioneve komunale, OJQ-ve dhe medieve, për rëndësinë e hartimit dhe miratimit të Planit të veprimit për të rinj, si dokument strategjik për të rinjtë në komunën e Ulqinit,
- ✓ Fuqizimi i të rinjve për t'u angazhuar në procesin e hartimit të Planit të veprimit në nivelin lokal.

Projekti zgjatë deri në fund të vitit dhe do të finalizohet me hartimin e plotë të Planit të Veprimit për të rinj dhe dërgimin e tij për procedurë parlamentare.

Ky projekt mbështetet nga programi *De Facto Equal*, të cilin e realizon **Fondi për qytetari vepruese (FAKT)**, i financuar nga Bashkimi Evropian nëpërmjet Delegacionit të BE-së në Mal të Zi.

REZULTATET E ANKETËS ME TË RINJ - ULQIN 2014

| 1 | Mosha e të anketuarve | përqindja |
|---|-----------------------|-----------|
| | 15 deri 19 vjeç | 18% |
| | 20 deri 24 vjeç | 45% |
| | 25 deri 29 vjeç | 37% |

2 A je anëtar i ndonjë organizate, shoqërie apo klubi sportiv!?

| përgjigjet e mundshme | nr. përgjigjeve | përqindja |
|-----------------------|-----------------|-----------|
| PO | 56 | 32% |
| JO | 118 | 68% |
| | 174 | 100% |




Përgjigjet me PO - anëtar në:

- * Klube sportive
- * Shoqata
- * Shkolla kërcimi
- * Forume rinore politike

- 3 Cilat nga këto fusha kanë më tepër rëndësi për ty?
(1 = fusha më e rëndësishme, 9 = fusha më pak e rëndësishme)

| fushat | prioritetet | përqindja |
|------------------------------------|-------------|-----------|
| Shëndeti | 1 | 16% |
| Arsimimi | 2 | 14% |
| Punësimi | 3 | 13% |
| Familja | 4 | 12% |
| Të drejtat e njeriut | 5 | 12% |
| Pjesëmarrja e të rinjve në shoqëri | 6 | 10% |
| Kultura | 7 | 8% |
| Koha e lire | 8 | 8% |
| Informimi dhe mobiliteti | 9 | 7% |
| | | 100% |

Fushat më të rëndësishme për të rinj



ARSIMIMI I TË RINJVE

4 A ke sugjerime konkrete nëse mendon se diçka mungon në lidhje me arsimimin formal (shkollë, fakultet) ose në arsimimin joformal (seminare, trajnime, sesione edukative) në Ulqin?


Sugjerimet e të rinjve:

- ✓ *Trajnime, seminare, kurse (gjuhë të huaja, informatike etj.).*
- ✓ *Biblioteka shkollore duhet të jetë më e pasuruar me literaturë,*
- ✓ *Hapja e Fakulteti të Turizmit (në të dy gjuhët),*
- ✓ *Më shumë drejtime në shkollën e mesme, më shumë kurse pa pagesë,*
- ✓ *Kushte me të mira në arsimin formal (aktivizimi i laboratorëve dhe kabinetëve të punës)*
- ✓ *Në shkolla të futen lëndë për shëndetin mendor dhe riprodhues, për sëmundjet ngjitëse etj.,*
- ✓ *Shkollat të kenë një zyre e cila shërben si një vend që këshillon maurantët në përzgjedhjen e universiteteve mundësin e fitimit të bursave, programe të shkëmbimit, studimi jashtë shtetit;*
- ✓ *Më shumë vende regjistrimi në shkollën e mesme, në gjuhën shqipe,*
- ✓ *Hapja e një tjetër shkollë të mesme,*
- ✓ *Të organizohen trajnime për profesorët në moshë që të jenë në hap me të rejtat (në lëndët e tyre).*
- ✓ *Sa më shumë seminare (jo politike) për hyrjen në NATO dhe integrimin evropian; për të drejtat e njeriut; zhvillimin e qëndrueshëm etj.*
- ✓ *Trajnime (shkolla) për debate, hartimin e eseve, CV-ve, për punë kreative, etj.*
- ✓ *Të hapet në Ulqin shkolla e gjuhëve të huaja, (siç është Oxford në qytetet tjera....)*

PAPUNËSIA është një problem i madh, jo vetëm në qytetin tonë, por në të gjithë Evropën.

5 **Politika rinore** këtë problem në mënyre specifike e trajton me një sërë masash. Cilat nga këto të duken më efektive? Në qoftë se ke sugjerime të tjera, të lutemi shënoje në hapësirën e zbratur.

| përgjigjet e ofruara | Prioritetet | Përqindja |
|--|-------------|-----------|
| Futja e orientimit profesional në shkollat fillore dhe të mesme në Ulqin | 1 | 26% |
| Masa që detyrojnë punëdhënësit për tu siguruar të rinjve mundësi për kryerjen e praktikave (punën praktike, stazhin..) | 2 | 23% |
| Programet e rikualifikimit (ndryshimi i profesionit përmes njohurive dhe aftësive të reja që kërkohen në tregun e punës) | 3 | 21% |
| Nxitja e vullnetarizmit | 4 | 15% |
| Sigurimi i kredive të volitshme për fillestarët në biznes | 5 | 15% |
| | | 100% |




SUGJERIMET E TË RINJVE:

- ✓ Promovimi i punimeve të vogla të bëra nga të rinjtë
- ✓ Hapja e institucioneve të reja (në nivel lokal),
- ✓ Oferta e degëve të mësimi të jetë në përputhje me nevojat konkrete të komunitetit lokal.
- ✓ Mësimi i artizanateve të vjetra të cilat pothuajse janë zhdukur,
- ✓ Investimi në një marketing të mirë për resurset vendase, si p.sh ulliri dhe vaji i ulliri etj.

SHËNDETI I TË RINJVE

6 Cilat nga këto dukuri beson se janë më të pranishme tek të rinjtë në Ulqin? Renditi sipas rëndësisë prej nr. 1 deri nr 6. (nr 1 – dukuria më e përhapur, nr 6 - dukuria që mendon se nuk është aq e shpeshtë).

| Dukuritë më të përhapura | oc | renditja | Përqindja |
|---|----|----------|-----------|
| Bixhozi | | 1 | 20% |
| Depresioni, pandjesia | | 2 | 17% |
| Mungesë informimi për shëndetin riprodhues | | 3 | 17% |
| Neglizhenca e të rinjve për çështjet e shëndetit mendor | | 4 | 16% |
| Varësia ndaj drogës | | 5 | 15% |
| Dhuna | | 6 | 15% |
| | # | | 100 |



SUGJERIME TË TJERA:


- ✓ Alkoolizimi,
- ✓ Prania e kafeneve afër shkollave, (ku dominon konsumimi i alkoolit dhe substancave psikoaktive)
- ✓ Bastoret

7

PJESËMARRJA E TË RINJVE NË SHOQËRI

A ke mundësi të marrësh pjese në ngjarjet që ty të interesojnë, në qytetin tënd?

| përgjigjet e mundshme | nr. i përgjigjeve | Përqindja |
|-----------------------|-------------------|-----------|
| PO | 42 | 24% |
| JO | 132 | 76% |
| | 174 | 100 |



PJESËMARRJA E TË RINJVE NË AKTIVITETE:

- ✓ Në aktivitete kulturore dhe artistike,
- ✓ Takime, tryeza të rrumbullakëta, në aktivitete të ndryshme si voluntarist,
- ✓ Në manifestimet që realizon organizata turistike
- ✓ Në aktivitetet e organizatave joqeveritare,
- ✓ Aktivitetet për mbrojtjen e ambientit
- ✓ Në ngjarje sportive.

PENGESAT PËR PJESËMARRJEN AKTIVE TË TË RINJVE:

- ✓ Mungesë informimi në lidhje me aktivitet që ndodhin (mediat në Ulqin në mënyrë të dobët i informojnë të rinjtë),
- ✓ Nuk ka ngjarje tërheqëse për të rinj, kështu që nuk ka as interesim
- ✓ Politizimi i aktiviteteve është pengesë për shumë të rinj,
- ✓ Mosinformimi në kohën e duhur (mungesë marketingu)

TË DREJTAT E NJERIUT

8 Nëse mendon që grupeve të të rinjve në Ulqin (të shënuara me poshtë) iu është mohuar ndonjë e drejtë, të lutem shënoje cila?

*** grave të reja**

- ✓ *E drejta e punësimit jo e barabartë me meshkujt,*
- ✓ *Nënave të vetme (kryefamiljare) iu janë privuar shumë të drejta, sidomos pamundësia e realizimit të mbështetjes së fëmijëve në të cilën ato kanë të drejtë,*
- ✓ *Diskriminimi dhe keqtrajtimi gjatë punësimit,*
- ✓ *Nuk favorizohen në jetën politike,*
- ✓ *Në shoqërinë tonë tradicionale, diskriminimi i grave të reja është i theksuar dhe në emër të tyre zakonisht vendosin baballarët, familjet. Ndërsa gratë e reja të emancipuara, diskriminohen për shkak të nevojës që t'i kundërvihen kësaj tradite.*

*** të rinjtë e pakicës egjiptiane dhe rome**

- ✓ *Diskriminim në punësim,*
- ✓ *Vështirë pranoen në shkolla,*
- ✓ *Nuk inkuadrohen në shoqëri (në jetën politike, institucionale)*
- ✓ *Ekziston diskriminimi i theksuar dhe përjashtimi ndaj këtij grupi. Ata, në kuadër të traditës së vet në përgjithësi janë të mbyllur dhe të tërhequr, por në shumicën e rasteve komuniteti lokal i diskriminon ato për shkak të përkatësisë së tyre nacionale dhe etnike.*

*** të rinjtë me pengesa në zhvillim**

- ✓ *Nuk iu kushtohet rëndësia dhe kujdesi i duhur nga shoqëria,*
- ✓ *Mungojnë rampat që mundësojnë ecjen e personave në karroca,*
- ✓ *Nuk inkuadrohen sa duhet në procesin arsimor,*
- ✓ *Të jenë më shumë të përfshirë në shoqëri,*
- ✓ *Diskriminohen nga vet familjet e tyre (nuk i lejojnë të ekspozohen),*
- ✓ *Nuk ka institucione për të rinjtë me probleme të shëndetit mendor.*

*** të rinjtë nga zonat rurale**

- ✓ *Ata konsiderohen si të pa shkollë dhe të painformuar,*
- ✓ *Kanë trajtim të pa barabartë gjatë mësimit (në raport me të rinjtë nga qyteti).*
- ✓ *Iu mungojnë objektet kulturore-sportive,*
- ✓ *Nuk ka transport të organizuar për ardhje në qytet (linja e autobusëve)*
- ✓ *Ekzistojnë stereotipe, që të rinjtë nga zonat rurale sikur nuk e kanë vendin në qytet.*

*** të rinjtë - familjet e të cilëve janë shfrytëzues të sigurimit material të familjes**

- ✓ *Ndihma sociale është e vogël dhe nuk iu mundëson të angazhohen në shoqëri,*
- ✓ *Gjendja e vështirë financiare nuk iu mundëson të emancipohen si bashkëmoshatarët e tyre,*
- ✓ *Në përgjithësi shoqëria pajtohet se familjeve të varfra iu ndihmohet, në çfarëdo forme, por problemi është se sa kjo ndihmë ndikon në përmirësimin e pozitës së këtyre personave.*

*** (grupe të tjera të të rinjve)**

- ✓ *Në të vërtetë, të drejtat e të rinjve shkelen në atë mënyre që zakonisht diskriminohen për një arsye (p.sh. njohja e njërit dhe jo e tjetrit, varësisht nga mjedisi që vinë, pozitës së prindërve të tyre, gjendjes materiale, etj.)*

KOHA E LIRË DHE TË RINJTË

- 9 A ke sugjerime konkrete nëse mendon se të mungojnë mënyrat cilësore për të kaluar kohën e lirë në Ulqin?

SUGJERIMET E TË RINJVE:

- ✓ *Kinema, teatër*
- ✓ *Qendra kulturore për të rinj,*
- ✓ *Basene për sportet ujore,*
- ✓ *Klube sportive (jo private – pa pagesë),*
- ✓ *Nxitja e sporteve femërore,*
- ✓ *Tereni sportiv për basketboll,*
- ✓ *Staza për biçikleta dhe staza për ecje,*
- ✓ *Rivënia në punë e Bibliotekës së qytetit,*
- ✓ *Klubi i leximit,*
- ✓ *Organizimi i garave komunale në fusha të ndryshme,*
- ✓ *Hapja e qendrave të mëdha tregtare*

KULTURA DHE TË RINJTË

- 10 A ke sugjerime konkrete nëse mendon se në Ulqin mungojnë ngjarje të veçanta kulturore për të rinj?

SUGJERIMET E TË RINJVE:


- ✓ *Shfaqje teatrale,*
- ✓ *Festivale rinore,*
- ✓ *Hapja e një shkolle të veçantë baleti dhe aktrimi,*
- ✓ *Karnevale dhe spektakle muzikore,*
- ✓ *Të organizohen punishte e atelie piktoresh (të udhëhequr nga piktorët, profesorët e qytetit)*
- ✓ *Ekspozita me krijimtari të të rinjve,*
- ✓ *Të stimulohet arti i fotografisë,*
- ✓ *Ngjarje rinore për të promovuar komunikimin ndërkulturor,*
- ✓ *Gazeta në të cilat të rinjtë mund të publikojnë poezitë e veta, tregimet, esetë, komentet, analizat e ndonjë libri, ku mund të informojnë publikun për ngjarjet kulturore etj.*

11

FAMILJA DHE TË RINJTË

Çfarë lloj mbështetjeje iu duhet të rinjve në Ulqin e që lidhet me martesën, krijimin e familjes, të qenët prind?

| Llojet mbështetëse | Prioritetet | Përqindja |
|--|-------------|-----------|
| Këshillim psikologjik | 1 | 23% |
| Këshillimore për të rinj | 2 | 20% |
| Qendra informative me materiale edukative | 3 | 20% |
| Vizita e institucioneve përkatëse të familjeve që janë në nevojë | 4 | 19% |
| Qendra mbështetëse për viktimat e dhunës në familje | 5 | 18% |
| | | 100% |



12

INFORMIMI DHE MOBILITETI

A ke sugjerime konkrete nëse mendon se në Ulqin të mungojnë informatat cilësore (emisione me përmbajtje për të rinjtë në TV apo radio, revista rinore) ose të mungojnë mundësitë e lëvizjes (udhëtimeve me karakter arsimor, kulturor dhe turistik)?

SUGJERIMET E TË RINJVE:

INFORMIMI

- ✓ *Mungesë e revistave rinore,*
- ✓ *Mungesë e emisioneve për të rinj në mediat lokale,*
- ✓ *Më shumë media lokale,*
- ✓ *Të lëshohet interneti (Wi-Fi) pa pagesë në Ulqin,*
- ✓ *Zonat rurale të pajisen me lidhje telefonike dhe internet,*
- ✓ *Të hapet zyra për të rinj në Komunë,*
- ✓ *Të themelohet qendra informative për të rinj.*

MOBILITETI

- ✓ *Të organizohen më shumë ekskursione për të rinj, në mënyrë që të njihen me kulturën e popujve të tjerë,*
- ✓ *Komuna të mbështesë udhëtimet e të rinjve me karakter edukativ dhe studimor,*
- ✓ *Komuniteti lokal të sigurojë më shumë bursa për studentë,*
- ✓ *Duhet të organizohen tribuna për maturantë, të cilat të rinjve iu prezantojnë mundësi studimi në regjion dhe jashtë vendit.*
- ✓ *Stimulimi i udhëtimeve turistike të të rinjve*
- ✓ *Organizimi i "shkollës në natyrë", ekskursioneve malore etj.*